



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:244528

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06453894

AC-I-24-0716

Në ankesën e

Paditësi

Sh I nga Gjilani, i përfaqësuar nga Avokati Sh Xh, Gjilan.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH "Industria e Duhanit" (në Likuidim) në Gjilan (në likuidim) e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, (AKP)**, Rruga, "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2501, të datës 7 gusht 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 14 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2501, i datës 7 gusht 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 11 prill 2014, paditësi për mes postës e dorëzoi në DHPGJS-së një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI003-0583/0099, të datës 10 mars 2014, me të cilën kërkesa e paditëses datës 21 shtator 2007 për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën gusht 2003-maj 2004 në shumë prej 1,872.83 euro, refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi në ankesë pohoi se ishte obligim ligjor i NSH-së të paguaj pagat e pa paguara, dhe se kërkesa nuk është parashkruar në bazë të ligjit. Ai pohon se ka dorëzuar kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit brenda afatit ligjor, duke u bazuar në Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Bashkë me ankesë ka bashkangjitur: vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, Listën e pagave të pa paguara njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, një kërkesë për ndërprerje të procedurës në lëndën C nr. 165/07 dorëzuar në gjykatën komunale në Gjilan dhe Aktvendimin e gjykatës komunale në Gjilan për ndërprerje të procedurës C nr.156/07 datë 21 maj 2008.

Me datë 12 korrik 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pretendon se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore materiale. AKP-ja pohon se paditësi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka paraqitur fakte për të mbështetur kërkesën në bazë të nenit 7 LPK-së. AKP-ja pohon se e mbështet Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me të cilin është refuzuar kërkesa për paga si e pavlefshme, pasi që kërkesa ishte parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja në mbrojtje në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 7 gusht 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-2501, ankesën e paditësit e aprovon si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit GJI003-0583/0099, të datës 10 mars 2014 dhe e obligon AKP-në që paditësit në emër të pagave të papaguara për periudhën gusht 2003-maj 2004, ti paguaj shumën prej 1,872.83 euro, interesin ligjor prej 10% në

shumën totale themelore 187.28 euro, që do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së arsyeton se paditësi ka dorëzuar si dëshmi në mbështetje të ankesës Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 15 gusht 2006 dhe Listat e pagave të pa paguara të lëshuara nga NSH-ja. Me rastin e aprovimit të kërkesës për paga për periudhën e cekur, gjykata është mbështetur në Listat e pagave të pa paguara që i përkasin periudhës gusht 2003-maj 2004. Sipas këtyre listave totali i shumës së mbetur borxh për periudhën e cekur në emër të pagave është shuma prej 1,872.83euro. Tutje Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka konstatuar se Njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 15 gusht 2006, e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës, andaj nuk është i bazuar pretendimi i AKP-së se kërkesa është parashkruar. Shkalla e I-rë e ka aprovuar edhe shumën prej 10% në borxhin kryesor ose shumën prej 187.28 euro, duke u bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, pasi që ishte kërkesë e paditësit.

Me datë 22 shtator 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS, një ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-2501, të datës 7 gusht 2024, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit, dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për më tepër në ankesë, AKP-ja ka pohuar se Gjykata e shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontekstit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur se afatet janë ngatërruar nga Gjykata. Afati i parë është ai për parashkrimin e kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta realizoj në Gjykatë e që është afati i aplikueshëm i parashkrimit bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Të dy këto afate janë të ndara dhe të dallueshme dhe se të dy afatet duhet të përmbushen në mënyrë që kërkesa të pranohet. Sa i përket konstatimit të gjykatës se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në parashkrimin, AKP sqaron se ky njoftim i referohet paditësit, se ai ka të drejtën të parashtrij kërkesën pranë AKP-së, dhe nuk i mbron të drejtat e tij me mjete tjera ligjore të cilat janë në dispozicion. Tutje AKP-ja e përsërit pretendimin e saj se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar. Në ankesë i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e shkallës së I-rë dhe të II-të të DHPGJS-së.

Më datë 16 tetor 2024, paditësi e ka pranuar ankesën e AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 21 shtator 2007, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "Industria e Duhanit" (në likuidim), një kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën Gusht 2003 deri maj 2004 në shumë prej 1,872.83 euro, e cila kërkesë ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit duke e vlerësuar se nuk bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës, pasi që Njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës.

Kolegji i Apelit nuk pajtohet me konstatimet e Autoritetit të Likuidimit, ndërsa i mbështet konstatimet e dhëna nga Shkalla e parë e DHPGJS, se kërkesa për paga nuk është parashkruar. Është e qartë se AKM-ja paditëses i ka dërguar Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me date 15 gusht 2006, i cili dokument e ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit të kërkesës.

Ne këtë njoftim shprehimisht ceket se "Shumat – pagat që u janë mbetur borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi

e Punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktohen i kur të fillojnë këto procedura”.

Duke u bazuar në këtë Njoftim, paditësi me arsye ka pritur fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-se me datë 04 korrik 2007, dhe pastaj pas njoftimit të shpallur nga AKP-ja, paditësja në afatin ligjor e ka dorëzuar kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit me datë 21 shtator 2007.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja me mbrojtjen në ankesë të dorëzuar në DHPGJS me datë 12 korrik 2024, e kundërshton kërkesën e paditësit për paga vetëm për shkak të parashkrimit, ndërsa nuk ka ndonjë kundërshtim shprehimor lidhur me lartësinë e kërkuar të kompensimit në shume të kërkuar prej 1,872.83 euro.

Andaj duke u bazuar në faktin që lartësia e kompensimit nuk është kundërshtuar nga AKP-ja në mbrojtje në ankesë, dhe duke u bazuar edhe në faktin se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e I-rë, ka sjellë si provë edhe Listat e pagave të punëtorëve të NSH-së, që kanë mbetur pa u paguar për periudhën gusht 2003 e deri 20 maj 2004, në të cilën listë paditësi është në numrin rendor 132, Kolegji i Apelit e mbështet Aktgjykimin e shkallës së I-rë të DHPGJS-së, me të cilin është aprovuar kërkesa e paditësit për paga në shumë prej 1,964.05 euro, dhe interesi ligjor prej 10% në shumë prej 187.28 euro, e cila do të paguhet sipas prioritetëve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditurës është refuzuar si e pa bazuar, ndërsa është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 30 shtator 2024 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 nëntor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
